



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

[Datë 04.10.2023]

*Formulari nr. 3*

**FTESË PËR OFERTË**

**Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri Bashkia Tiranë  
Adresa Sheshi “Skenderbej”, Tiranë  
Tel/Fax 0035542256799  
E-mail administrative.prokurime@tirana.al  
Adresa e Internetit [www.tirana.al](http://www.tirana.al)

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 3 (tre) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Otava-Toronto-Tiranë”**.

Data e zhvillimit do të jetë **04.10.2023 ora 16.25** në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

**1. “Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Otava-Toronto-Tiranë ”, si më poshtë:**

- Nisja nga Tirana drejt Otava do të bëhet në datën 08.10.2023 në orën 06.20, mbërritja në Otava në orën 19.12 (me dy ndalesa).
- Nisja nga Otava në Toronto do të bëhet në datën 10.10.2023, në orën 12.00, mbërritja në Toronto në orën 13.08 (pa ndalesë).
- Nisja nga Toronto drejt Tiranës do të bëhet në datën 12.10.2023, në orën 22.35, mbërritja në Tiranë të nesermen në orën 16.40 (me një ndalesë).

(bagazhe të përfshira) .

1. “Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Otava-Toronto-Tiranë”, si më poshtë:

- Nisja nga Tirana drejt Otava do të bëhet në datën 09.10.2023 në orën 06.20, mbërritja në Otava në orën 18.12 (me dy ndalesa)..
- Nisja nga Otava në Toronto do të bëhet në datën 10.10.2023, në orën 12.00, mbërritja në Toronto në orën 13.08 (pa ndalesë).
- Nisja nga Toronto drejt Tiranës do të bëhet në datën 11.10.2023, në orën 17.50, mbërritja në Tiranë të nesërmen në orën 11:20 (me një ndalesë) .

(bagazhe të përfshira) .

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) *Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.*

*\*Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: [administrative.prokurime@tirana.al](mailto:administrative.prokurime@tirana.al)) brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në “Ftesën për ofertë” do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.